

[Emri i Organizatës]

[Logo]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqata "Mjedis, Ujëra, Pyje"
PËRMET

Andresa: Blloku "Stavri Vinjau" Përmet. NIPT L19611291C
E-mail: alidelilaj53@gmail.com Cel. 0692035222. Nr. Postar 6401

Drejtuar: Rrjetit GreenAL TIRANË

Dërgon: Shoqata "Mjedis, Ujëra, Pyje" PËRMET.

Bashkngjitur po ju dërgojmë: Formularin e aplikimit, (Factsheetfleta e të dhënave për Shoqatën MUP), CV e Shoqatës dhe Logon.

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 29. 06. 2011
- Statusi Ligjor: Organizat jo Qeveritare, Shoqatë.
- Selia Qendrore: Rrethi i Përmet, Qyteti Përmet, Shqipëri.
- Faqja e Internetit: www.simplesite.com
- Email kryesor i organizatës: alidelilaj53@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: 0355692035222

2. Misioni

Qellimi i Shoqatës M.U.P. është të mbështesë dhe të nxitë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar social - ekonomik, të organizatave e grupeve të ndryshme rinore, grave, të pakicave kombëtare, të shtresave në nevojë, e në veçanti të pensionistëve e të moshuarve të vetmuar etj, bazuar në burimet dhe pontecialet natyrore që ka territori i Përmetit dhe në tërsi i Shqipërisë.

3. Vizioni (Opsionale)

Shoqata punon me Vizionin sipas preambulës së saj: "Të dyja, qoftë mjedisi shoqëror, qoftë ai natyror përfshi atë të krijuar nga dora e njeriut, janë thelbësore për permiresimin e cilesisë së jetës dhe për gëzimin paqësor të të drejtave të njeriut, përfshirë dhe të drejtën për jetën në vetvete dhe për të trashëguar çdo gjë të vyer të trashëgimis së popullit tone".

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- Mbrojtja e Mjedisit.
- Menaxhimi i qendrueshem i peisazhit te burimeve termale.

- Mbrojtja e Natyrës dhe zhvillimi i Turizmit.
- Zhvillimi i Komunitetit, puna me të rinjtë dhe fëmijët.
- Zbutja e Ndryshimeve Klimatike.
- Kulturën dhe trashëgimin kulturore.
- Rritja e mirqënjes së moshës së tretë.
- Mbrojtjen dhe Mbarshtim i Pyjeve dhe kullotave.
- Etj.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Realizuar mbi 15 projekte me tematikën kryesore mjedisin, natyrën, turizmin , puna me të rinjtë dhe fëmijet, trashëgimia kulturore, contribute dhe ndihma për moshën e tretë, mbrojtja dhe mbashtimi i pyjeve etj.

Do tregoj realizimin e disa projekteve, të tjerët I gjeni tek CV e Shoqatës

- **Projekti/Programi 1:** Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile (**AMSHC**) në thirrjen 17 pati si objekt: “Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse si dhe forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme”, financoi projektin: **“Ti nuk je vetëm”**, për mbështetjen e moshës së tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë. Qëllimi kryesor i projektit të kontribuojë në rritjen e mirëqënies të moshës së tretë në Përmet duke përmirësuar shërbimet sociale të ofruara për këtë kategori.

(Qershor - Dhjetor 2024)

- **Projekti/Programi 2:** Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perndimor (**ReLOaD**) financoi projektin: **“Afrojmë të rinjtë drejtë jetesës së shëndetshme”**. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetesës të të rinjve duke përmirësuar infrastrukturën publike lokale dhe cilësinë dhe aksesin në shërbime. Për të kontribuar në arritjen e qëllimit të përgjithshëm ky projekt ka dy objektiva specifike: - Të përmirësojë infrastrukturën e mjedisit sportiv në qytet. - Të rrisë përfshirjen e të rinjve në aktiviteteve për promovimin e jetes së shëndetshme.

(Mars – Gusht 2023).

- **Projekti/Programi 3:** Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perndimor (**ReLOaD**) financoi projektin: **“Rijetzimi i trashëgimisë kulturore- turistike në breza”**. Projekti pati si qëllim të përgjithshëm të kontribojë në promovimin dhe edukimin e të rinjve duke përcjellë në breza trashëgimin e pasur kulturore e turistike të Përmetit. Ai synoj rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve në veçanti e të shoqërisë për vlerat, traditat, historinë dhe shpirtin patriotik të komunitetit përmetar, si dhe angazhimin e tyre në aktivitete të ndryshme për mjedisin dhe turizmin si burim i madh ekonomik për zonën e Bashkisë së Përmetit.

(Mars – Tetor 2022).

- **Projekti/Programi 4:** Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perndimor (**ReLOaD**) financoi projektin: **“Fëmij të lumtur, të sigurt dhe të shëndetshëm”**. Qëllimi i projektit ishte mbështetja që duhet tu bëhesh kopshteve dhe çerdheve me paisje dhe mjete të nevojshme ne

situsten aktuale për të përballuar COVID-19 si dhe edukim i fëmijëve dhe trajnim i Edukatoreve me veprimet me elementare për masat për uljen e riskut të infektimit nga virusi duke patur bazë udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë . (Shkurt 2020 - Gusht 2020).

- Projekti/Programi 5: **A.ZH.B.R** financon projektin e shërbimit mjedisor: **"Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve"**. Qëllimi i pyllëzimit është të parandalojë erozionin sipërfaqësor dhe të sigurojë instalimin e grumbullit pyjor në një sipërfaqe improduktive dhe të eroduar. Nepërmjet pyllëzimit të këtij objekti me fidana pyjorë të llojit pishë të butë që është një llojë. I përshtatshëm për zonën në do të realizojmë: Pengimin e fenomenit të erozionit. Krijimin e një brezi mbrojtës për pengimin e dherave për në rezervuar dhe shtimin e sipërfaqes së gjelbërues dhe përmirësimin e peisazhit. . (Gusht 2019 - Qershor 2020).
- Projekti/Programi 6: Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (**ReLOaD**) financon projektin: **"Të rinj aktiv në mbrojtje të mjedisit"**. . . Mjedisi është një pasuri e përbashkët, e cila nuk na përket vetëm ne por edhe brezave të ardhshëm. Hapi më i rëndësishëm drejtë të ardhme për mjedisin është dhe duhet të jetë edukimi mjedisor. Edukimi mjedisor, veçanërisht për të rinjtë, na ndihmon të krijojmë një raport të ri me mjedisin dhe natyrën. Dhe pikërisht ky ishte fokusi i këtij projekti: Ndërgjegjësimi i të rinjve për të qënë më aktivë në mbrojtjen e mjedisit që i rrethon, duke kontribuar në mbrojtjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore në rrethin e Përmetit. (Shkurt 2019 - Janar 2020).
- Projekti/Programi 7: **Ministria e Kulturës** financon për realizimin e projektit: **Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të Trashëgimisë Kulturore dhe Mjedisore ndër breza**. Qëllimi i këtij projekti ishte informimi, ndërgjegjësimi, edukimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mjedisore përmetare ndër breza, duke filluar nga të rinjtë. Vizioni tonë ka synuar në nxitjen e të rinjve për tu angazhuar në aktiviteteve me karakter kulturor, si konkurse mbi trashëgiminë kulturore dhe atë mjedisore, si një formë efektive dhe inovative edukimi. Mbrojtja, promovimi dhe rijetëzimi ndër breza i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mjedisore përmetare ka qënë si qëllim kryesor (Janar 2019 - Korik 2019).
E të tjera.

6. Shtrirja Gjeografike

Shoqata për zbatimin e Projekteve ka operuar në të gjithë rrethin e Përmetit

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Ali Delilaj

Bordi i Drejtuesve: Ali Delilaj, Dorian Meraj, Miselda Elmazi, Zamir Spahiu, Katerina Çapoku.

Shoqata të regjistruar ka 110 anëtar, 48% shoqe

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Shoqata për realizimin e Projekteve ka bashkpunuar me donatorët si *ReLOaD, AMSHC, REC ALBANIA, Ministria e Kulturës, Bashkia Përmet, Bashkia Këlcyrë, SAVE THE CHILDER*, ish Komunat, Sukë, Çarçovë, Frashër etj

Në qëndër të punës së shoqatës ka qënë vullnetarizmi nga të rinjtë e gratë e qytetit, nxënësit e shkollave nëpërmjet aksioneve të pastrimit në qytet, lumin Vjosa, Ujërat Termale, Kanionin e Lengaricës etj

9. Ndikimi (Opsionale)

Shoqata “Mjedis, Ujëra, Pyje” ka qënë ndër 23 organizatat e para që ka firmosur për mbrojtjen e lumit Vjosa në mars 2013, ku dhe kemi bashkpunuar me një numur të madh OJQ mjedisore në vend, por duke qënë edhe pjesë e Rrjetëzimeve Mjedisore.

Rezultatet e matshme kanë qënë të shumta, por nga më kryesoret kanë qënë ndertimi dhe rregullimi i dy burimeve të ujërave termale Bënjë Lengaricë, mbjellja e bllokut 10 hektar me pishë të Butë në Goricë-Sukë, bërja e 5 lerave për uji të pijshëm për blektorinë dhe pastrim 120 ha kullote në malin e Trebeshinës, përpilimi i tre projekteve për mbjelljen e arrorve, Frashëe, Çarçovë e Ballaban, paisja e një Kopshti Fëmijësh në Bashkin Përmet me paisje të domosdoshme si dollap, tavolina, karike për fëmijet e kopshtit e të çerdheve, lodra e paisje higjienike në kohën e COVID-19, ngritja e këndit të forces në natyrë në Bashkinë Përmet etj

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- [Numri] i njerëzve të përfshirë në çdo aktivitet në zbatimin e projekteve nuk ka qënë më i vogël se 50 veta, mbi 50% kanë qënë shoqe. Aksionet kanë qënë mbi 200 persona
- [Numri] i pemëve të mbjella rreth 25,000 fidanë nga të cilët 22,200 rrënjë Pishë e Butë të Sukë tëmbjella në një bllok prej 10 ha
- [Numri] i politikave të influencuara, disa.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Çdo aktivitet i Projekteve të zhvilluara janë pasqyruar në medja të ndryshme si aktivitete artistike, shfaqje, aksione të pastrimit, dhënje çmimesh, promovime etj në TVSH, TVSH Gjirokastra, TVSH Korça, Facebook, Instagram. Fillimisht reklamë e madhe u janë bërë burimeve të ujërave termale të Bënjës të cilat edhe u bënë tërheqs dhe vëndi më i vizituar i turistëve.

Për Shoqatën “Mjedis, Ujëra, Pyje” Përmet

Kryetari

Ali Delilaj